REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E
SUHAREKËS
DREJTORIA PËR EKONOMI,
BUXHET DHE FINANCA

29-09-2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

MARRË NË DORËZIM-PRIMLJENO-RECEIVED

Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
04-316	43192		

BUXHETIMI I PËRGJEGJSHËM GJINOR (BPGJ)

Plani Buxhetit për vitet 2027–2029

Shtator 2026

1. Gjendja gjinore dhe demografike e Komunës së Suharekës

1.1 Baza ligjore dhe institucionale

Në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, të konsoliduar më 23.05.2025, BPGJ trajtohet si pjesë e integrimit të perspektivës gjinore në politikat publike dhe në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve. Për këtë arsye, ky dokument shtrihet në të gjitha kategoritë kryesore të buxhetit dhe jo vetëm në masat që kanë objektiv të drejtpërdrejtë gjinor. Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës kërkon që politikat dhe vendimet publike që prekin fëmijët të orientohen nga interesi më i mirë i fëmijës, mirëqenia, zhvillimi, edukimi, shëndeti dhe mbrojtja e tij. Këto parime përdoren në këtë dokument si bazë për ndërlidhjen e BPGJ-së me buxhetimin për fëmijë.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) për periudhën 2027–2029 synon integrimin e perspektivës gjinore në planifikimin, alokimin, zbatimin dhe monitorimin e burimeve publike. Dokumenti mbështetet në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Rregulloren (QRK) Nr. 12/2016 dhe parimet e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. BPGJ nuk paraqet një buxhet të veçantë vetëm për grate ose burrat, por analizon se si politikat, shërbimet dhe shpenzimet publike ndikojnë te gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.

1.2 Analiza demografike

Sipas Regjistrimit të Popullsisë 2024 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Komuna e Suharekës ka 45,749 banorë: 22,716 burra dhe 23,033 gra. Grat përbëjnë 50.35%, ndërsa burrat 49.65%. Në vitin 2011, popullsia ishte 59,722 banorë, prej tyre 29,478 burra dhe 30,244 gra. Kjo tregon një rënie të konsiderueshme të popullsisë së regjistruar ndërmjet dy regjistrimeve dhe e bën të rëndësishme që planifikimi i shërbimeve të mbështetet në të dhënat më të fundit demografike.

Viti	Burra	Gra	Gjithsej	% Burra	% Gra
2011	29,478	30,244	59,722	49.36%	50.64%
2024	22,716	23,033	45,749	49.65%	50.35%

Burimi: ASK, Regjistrimi i Popullisë 2011 dhe 2024, tabela e popullsisë së Suharekës sipas vendbanimit dhe gjinisë.

1.3 Fushat prioritare të ndërhyrjes

Lidhja ligjore: të dhënat e ndara sipas gjinisë janë bazë për identifikimin e nevojave të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve dhe për orientimin e burimeve publike. Për komponentin e fëmijëve, planifikimi duhet të marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës, mosdiskriminimin dhe qasjen në shërbime. Kjo e bën analizën demografike bazë për të dyja perspektivat: barazinë gjinore dhe të drejtat e fëmijës.

- fuqizimi ekonomik i grave dhe qasja e tyre në programe bujqësore, biznes dhe punësim;
- qasja e barabartë në arsim, kujdesin parashkollor, shërbimet shëndetësore dhe sociale;
- përmirësimi i sigurisë, ndriçimit, qasshmërisë dhe mobilitetit në hapësirat publike;
- rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në kulturë, rini dhe sport;
- mbledhja dhe raportimi i të dhënave të përfituesve sipas gjinisë për subvencionet dhe shërbimet;
- lidhja e investimeve kapitale me përfituesit realë dhe ndikimin e tyre gjinor.

2. Lidhja e BPGJ-së me strukturën e buxhetit 2027–2029

Sipas Tabelës 4.1 të Buxhetit Komunal 2027–2029 të Komunës së Suharekës, buxheti i përgjithshëm planifikohet në 24,376,967 € për vitin 2027, 25,065,129 € për vitin 2028 dhe 26,399,316 € për vitin 2029. BPGJ-ja duhet të lidhet me të gjitha kategoritë kryesore të shpenzimeve dhe jo vetëm me subvencionet.

Kategoria	2027 (€)	2028 (€)	2029 (€)	Lidhja me BPGJ
Paga dhe shtesa	13,750,057	13,818,808	13,887,902	Struktura e stafit sipas gjinisë
Malira dhe Shërbime	2,594,361	2,625,000	2,767,000	Përdoruesit e shërbimeve
Shpenzime komunale	385,800	395,000	400,000	Qasje në objekte/shërbime
Subvencione & transfere	680,000	717,000	735,000	Përfituesit gra/burra
Shpenzime kapitale	3,920,452	4,371,785	5,327,258	Qasje, siguri, arsim, shëndetësi
Shpenzime kapitale THV	1,386,797	1,317,536	1,408,156	Investime të financuara edhe nga THV
TOTALI	24,376,967	25,065,129	26,399,316	Buxheti komunal

Burimi: Tabela 4.1 sistemi BDMS dhe Tavelo 4.2 sistemi PIP I Buxhetit Komunal 2027–2029-Suharekë.

2.1 Të hyrat dhe burimet e financimit

Lidhja ligjore: çdo burim financimi dhe çdo alokim duhet të shqyrtohet sipas ndikimit të tij te gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Për programet që prekin fëmijët, përdorimi i burimeve duhet të lidhet me qasjen, mirëqenien, edukimin, shëndetin dhe mbrojtjen e fëmijës. Kjo qasje është në përputhje me detyrimin për integrimin e BPGJ-së në fushat publike dhe me parimet e Ligjit Nr. 06/L-084 për mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës.

Struktura buxhetore e Suharekës përfshin financimin nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe të hyrat vetanake. Nga perspektiva e BPGJ-së, rëndësi ka që edhe mjetet nga të hyrat vetanake të analizohen sipas përfituesve dhe ndikimit gjinor, sidomos në subvencione, shërbime dhe investime.

2.2 Treguesit kryesorë për BPGJ

Treguesi	2024 / bazë	2027–2029	Përdorimi në BPGJ
Populisia	45,749	—	Baza demografike
Gra	23,033	—	50.35% e populisisë
Burra	22,716	—	49.65% e populisisë
Stafi i planifikuar	—	1,394	Analizë e pagave sipas gjinisë
Paga dhe shtesa	—	13.75m / 13.82m / 13.89m €	Shpërndarja sipas gjinisë
Subvencione	—	680k / 717k / 735k €	Përfituesit sipas gjinisë
Investime kapitale + THV	—	5.31m / 5.69m / 6.74m €	Ndikimi direkt te qytetari

3. Arsimi, nxënësit dhe buxhetimi për fëmijë

Ndërlidhja ligjore me fëmijët dhe barazinë gjinore: arsimi është fushë me ndikim të drejtpërdrejtë te fëmijët. Ligji Nr. 06/L-084 ndalon privimin e fëmijës nga e drejta për edukim dhe arsimim dhe kërkon qasje gjithëpërfshirëse, mundësi të barabarta dhe pa diskriminim në arsimin parauniversitar. Në BPGJ kjo zbatohet përmes analizës vajza/djem, qasjes në çerdhe e shkolla, kushteve të mësimit, stafit dhe investimeve arsimore. Në të njëjtën kohë, Ligji Nr. 05/L-020 kërkon që perspektiva gjinore të integrohet në shpërndarjen e burimeve; prandaj buxheti për arsim analizohet edhe sipas ndikimit të tij te vajzat dhe djemtë dhe, kur është relevante, te gratë dhe burrat si prindër/kujdestarë.

ASK, në tabelën për popullsinë 5–29 vjeç që aktualisht vijon shkollimin, evidenton për Komunën e Suharekës 10,231 persona që vijojnë shkollimin: 5,226 djem dhe 5,005 vajza. Të dhënat ndahen edhe sipas niveleve të arsimit.

Niveli	Gjithsej	Djem	Vajza
Gjithsej	**10,231**	**5,226**	**5,005**
Parashkollor	311	186	125
Shkolla fillore (1–5)	3,132	1,678	1,454
E mesme e ulët (6–9)	3,108	1,655	1,453
E mesme e lartë (10–13)	1,879	942	937
Bachelor	1,629	705	924
Master	166	57	109
Doktoraturë	6	3	3

Burimi: ASK, Tab. 4.7 – Popullsia 5 deri 29 vjeç që aktualisht vijon shkollimin sipas nivelit, gjinisë dhe komunës, Regjistrimi 2024.

3.1 Të dhënat e arsimit parauniversitar 2023/2024

Sipas statistikave të arsimit 2023/2024 të MASHT/ASK, në Suharekë janë raportuar 548 fëmijë në arsimin parafillor, 312 djem dhe 236 vajza. Në raportimet komunale për vitin shkollor 2023/2024 janë evidentuar 8,788 nxënës në të gjitha nivelet, duke përfshirë çerdhen "Flutura"; në nivelin I–IX janë raportuar 6,686 nxënës, ndërsa në X–XIII 1,903 nxënës.

Treguesi	Gjithsej	Djem	Vajza
Arsimi parafillor (5 vjeç)	548	312	236
Arsimi I–IX	6,686	—	—
Arsimi X–XIII	1,903	961	942
Gjithsej sipas raportimit 2023/24	**8,788**	—	—

Burimi: MASHT/ASK, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2023/2024; raportimet e Komunës së Suharekës. Për I–IX nuk u përdor ndarje gjinore pa burim të drejtpërdrejtë në tabelën e cituar.

3.1.1 Buxheti i arsimit dhe lidhja me BPGJ-në dhe buxhetimin për fëmijë

Buxheti i arsimit dhe struktura e shpenzimeve

Arsimi parauniversitar përbën një nga fushat kryesore të shpenzimeve të Komunës së Suharekës dhe ka rëndësi të veçantë për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor dhe Buxhetimin për Fëmijë. Përveç pagave dhe shtesave, të cilat janë analizuar veçmas sipas gjinisë, financimi i arsimit përfshin edhe mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet, si dhe investimet kapitale. Këto kategori përcaktojnë drejtpërdrejt kushtet në të cilat ofrohet shërbimi arsimor dhe qasjen e fëmijëve në ambiente të sigurta, funksionale dhe të përshtatshme për mësim.

Në kuadër të BPGJ-së, rëndësi nuk ka vetëm shuma e mjeteve të ndara për arsim, por edhe mënyra se si këto mjete shpenzohen dhe cilat nevoja të nxënësve mbulohen. Për këtë arsye, secila kategori e shpenzimeve duhet të lidhet me funksionin që kryen në ofrimin e shërbimeve arsimore dhe me ndikimin e saj te vajzat dhe djemtë.

Mallrat dhe shërbimet përfshijnë shpenzime që mbështesin funksionimin e përditshëm të institucioneve arsimore, furnizimet dhe shërbimet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. Nga perspektiva e BPGJ-së, këto shpenzime duhet të vlerësohen në raport me cilësinë e shërbimeve që u ofrohen nxënësve, kushtet e mësimit dhe nevojat e ndryshme të vajzave dhe djemve.

Shpenzimet komunale lidhen me funksionalitetin e objekteve arsimore dhe përfshijnë nevoja që mundësojnë funksionimin e rregullt të shkollave. Në këtë kategori, analiza gjinore dhe ajo për fëmijët duhet të fokusohet në faktin nëse objektet janë funksionale, të sigurta dhe të qasshme për të gjithë nxënësit, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta.

Subvencionet dhe transferet, kur lidhen me fushën e arsimit, duhet të analizohen sipas përfituesve dhe qëllimit të mbështetjes. Për BPGJ-në është e rëndësishme që të monitorohet nëse mbështetja arrin në mënyrë të barabartë te vajzat dhe djemtë dhe nëse kontribuon në uljen e pengesave për pjesëmarrjen dhe vijimin e arsimit.

Investimet kapitale në arsim

Një komponent veçanërisht i rëndësishëm i buxhetit të arsimit janë investimet kapitale, pasi ato krijojnë ndikim shumëvjeçar në kushtet e mësimit dhe në qasjen e fëmijëve në shërbimet arsimore. Tabela 4.2 e Investimeve Kapitale për Komunën e Suharekës parasheh investime kapitale gjithsej 5,307,249 € në vitin 2027, 5,689,321 € në vitin 2028 dhe 6,735,414 € në vitin 2029, përkatësisht 17,731,984 € për periudhën 2027–2029.

Granti I Përgjithsëm I ka ndihmuar Grantitt ë Arsmit për vitin 2027 në vlerë prej 2,175,502.80 €.

Programi arsimor	Stafi 2027	Buxheti 2027 (€)	Buxheti 2028 (€)	Buxheti 2029 (€)
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	46	423,729.20	427,662.70	427,662.70
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	761	7,172,576.40	7,016,929.40	7,084,029.40
Arsimi i mesëm i lartë	195	1,810,076.20	1,880,076.20	1,880,076.20
GJITHSEJ ARSIMI	**1002**	**9,406,381.80**	**9,324,668.30**	**9,391,768.30**

Këto investime nuk duhet të shihen vetëm si shpenzime infrastrukturore. Ato ndikojnë në **sigurinë e nxënësve, cilësinë e mjedisit mësimor, qasjen në arsim, mundësitë për aktivitete sportive dhe mirëqenien e fëmijëve**. Për BPGJ-në, është e rëndësishme që gjatë zbatimit dhe raportimit të projekteve të identifikohen përfituesit dhe të monitorohet ndikimi te vajzat dhe djemtë. Brenda këtyre investimeve janë përfshirë projekte që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në arsim dhe te fëmijët, ndër të tjera: Rikonstruimi i SHFMU-së Sllapuzhan dhe objekteve të tjera shkollore; Rikonstruimi i SHP "Avdyl Rama"; Rikonstruimi i shkollave në disa vendbanime; ndërtimi dhe përmirësimi i hapësirave sportive, përfshirë sallën sportive në Peqan. Në këtë kuadër, investimet në shkolla duhet të lidhen edhe me **qasshmërinë dhe sigurinë**. Për shembull, infrastruktura shkollore, ndriçimi, rrugët e qasjes, hapësirat sportive dhe objektet e përshtatura ndikojnë jo vetëm në procesin mësimor, por edhe në mënyrën se si fëmijët lëvizin dhe marrin pjesë në jetën shkollore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kuadër të buxhetimit për fëmijë.

Burimi: Plani i Buxhetit 2027–2029 i Komunës së Suharekës dhe Tabela BPGJ e pagave 2027–2029. Vlerat e tabelës paraqesin totalet e programeve arsimore sipas planit buxhetor

3.2 Analiza e rasteve të lehonisë dhe rasteve me pagë zero në arsimin parauniversitar

Në kuadër të analizës së stafit dhe shpenzimeve për paga, janë shqyrtuar të dhënat e Listës së Pagave për muajin gusht 2026 për arsimin parauniversitar në Komunën e Suharekës. Analiza evidenton raste të pushimit të lehonisë dhe raste me vlerë Bruto/Neto zero, të cilat kanë rëndësi për planifikimin e stafit, zëvendësimeve të përkohshme dhe shpenzimeve për paga në periudhën 2027–2029. Lista e pagave paraqet dokumentin burimor për këtë analizë.

Nënprogrami	Stafi i planifikuar	Raste lehonie	Gra me Bruto/ Neto 0 €	Burra me Bruto/ Neto 0 €	Gjithsej raste me 0 €
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	52	5	3	0	3
Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët	754	13	8	5	13
Arsimi i mesëm i lartë	193	2	4	0	4
Gjithsej	999	20	15	5	20

Të dhënat e planifikimit për këto tri nivele të arsimit parauniversitar përfshijnë gjithsej 999 të punësuar. Nga analiza e listës së pagave janë evidentuar 20 raste me vlerë Bruto/Neto zero, prej të cilave 15 gra dhe 5 burra. Rastet e lehonisë dhe rastet e tjera të mungesës së përkohshme merren parasysh në planifikimin e stafit dhe të pagave, me qëllim të vazhdimësisë së procesit arsimor.

Nga perspektiva e BPGJ-së dhe e buxhetimit për fëmijë, trajtimi i rasteve të lehonisë ka rëndësi të drejtpërdrejtë për krijimin e kushteve që fëmija të ketë kujdes, mbrojtje dhe zhvillim të përshtatshëm gjatë periudhës së hershme të jetës. Për këtë arsye, planifikimi i zëvendësimit të përkohshëm të stafit gjatë mungesës së lehonisë nuk trajtohet vetëm si çështje e menaxhimit të personelit, por edhe si masë që mbështet vazhdimësinë e shërbimeve publike dhe interesin më të mirë të fëmijës.

Kjo qasje është në përputhje me parimet e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili përcakton interesin më të mirë të fëmijës si konsideratë mbizotëruese në veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën dhe kërkon masa për të siguruar mirëqenien dhe zhvillimin e tij. Në këtë kuptim, BPGJ-ja e ndërlidh analizën e lehonisë me buxhetimin për fëmijë dhe me vazhdimësinë e shërbimeve arsimore.

3.3 Baza ligjore për trajtimin e rasteve të lehonisë, rastëve me gjendje të rëndë shëndetësore dhe zëvendësimit në arsimin parauniversitar

Lidhja me buxhetimin për fëmijë: rastet e lehonisë nuk trajtohen vetëm si çështje e personelit dhe pagave. Ato lidhen me mbështetjen e familjes, kujdesin për fëmijën dhe vazhdimësinë e shërbimeve publike. Për këtë arsye, planifikimi i zëvendësimit të përkohshëm duhet të sigurojë vazhdimësinë e mësimit dhe shërbimeve për fëmijët, duke respektuar njëkohësisht të drejtat e punonjësve dhe parimet e barazisë gjinore. Ligji Nr. 06/L-084 e vendos mirëqenien dhe interesin më të mirë të fëmijës në qendër të veprimeve institucionale.

Sipas Nenit 11, pika 1, të Ligjit Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, organizatat buxhetore nuk mund të tejkalojnë numrin e të punësuarve në nivel të nënprogramit, përveç rasteve të lehonave dhe mësimdhënësve në gjendje të rëndë shëndetësore në sistemin e arsimit parauniversitar. Kjo dispozitë përbën bazë të rëndësishme për trajtimin e zëvendësimeve të përkohshme të stafit në këto raste.

> *"Asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkalojë numrin e të punësuarve në nivel të nënprogramit, në asnjë kohë gjatë vitit fiskal 2026 siç specifikohet në tabelat 3.1 dhe 4.1 të bashkëngjitura në këtë ligj, përveç lehonave dhe mësimdhënësve në gjendje të rëndë shëndetësore në sistemin e arsimit parauniversitar. Çdo tejkalim i numrit të lejuar të të punësuarve, përveç lehonave dhe mësimdhënësve në gjendje të rëndë shëndetësore në arsimin parauniversitar dhe ndarjeve buxhetore të parapara për çdo nënprogram, konsiderohet shkelje ligjore dhe do të merren masa ligjore ndaj personave përgjegjës sipas strukturës së organizatës buxhetore, bazuar në legjislacionin në fuqi."*

Në zbatim të kësaj baze ligjore, rastet e lehonisë të evidentuara në listat e pagave duhet të merren në konsideratë në planifikimin e nevojave për zëvendësim të përkohshëm, ndërsa angazhimi dhe financimi përkatës duhet të dokumentohen dhe të arsyetohen në përputhje me procedurat dhe ndarjet buxhetore në fuqi.

Shënim metodologjik për planifikimin 2027–2029: Përjashtimi i përmendur në Ligjin Nr. 10/L-001 është dispozitë e Ligjit të Ndarjeve Buxhetore për vitin 2026 .

4. Pagat dhe shtesat për të punësuarit

Lidhja me Ligjin për Barazi Gjinore dhe buxhetimin për fëmijë: analiza e pagave sipas gjinisë synon të bëjë të dukshme shpërndarjen e burimeve publike dhe strukturën e stafit sipas grave dhe burrave. Rastet e lehonisë dhe zëvendësimeve në arsim lidhen gjithashtu me vazhdimësinë e shërbimeve për fëmijët. Prandaj, kjo kategori analizohet në dy dimensione: barazia në burimet njerëzore dhe financiare, dhe kapaciteti i komunës për të ruajtur shërbimet që u ofrohen fëmijëve.

Analiza e pagave për Suharekën bazohet në tabelën gjinore të pagave 2027–2029 të përgatitur për këtë BPGJ. Për vitin 2027 janë planifikuar 1,394 të punësuar: 583 burra dhe 811 gra. Kjo strukturë mbahet në planifikimin 2028–2029 në mungesë të një strukture të re gjinore të stafit.

Viti	Stafi gjithsej	Burra	Paga burra (€)	Gra	Paga gra (€)	Total paga (€)
2027	1,394	583	5,855,533.61	811	7,894,523.39	13,750,057.00
2028	1,394	583	5,895,980.58	811	7,922,827.42	13,818,808.00
2029	1,394	583	5,921,817.08	811	7,966,084.92	13,887,902.00

Burimi: Tabela BPGJ e pagave 2027–2029 për Komunën e Suharekës. Pozitat e lira janë konsideruar të plotësohen me gra.

4.1 Pagat sipas njësive organizative – 2027

Njësia organizative	Stafi	Burra	Paga burra (€)	Gra	Paga gra (€)	Total (€)
Zyra e Kryetarit	18	11	144,283.21	7	75,259.39	219,542.60
Administrata	36	24	224,088.66	12	122,772.23	346,860.89
Inspektimet	10	8	110,037.52	2	24,082.90	134,120.42
Zyra e Kuvendit Komunal	31	17	176,121.98	14	135,378.43	311,500.41
Buxhetimi	23	7	80,557.56	16	160,608.81	241,166.37
Infrastruktura Rrugore	24	23	280,091.39	1	16,044.42	296,135.81
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	1	1	9,510.90	0	0.00	9,510.90
Bujqësia	4	4	66,523.45	0	0.00	66,523.45
Shërbimet kadastrale	13	8	90,204.92	5	55,054.56	145,259.48
Planifikimi urban dhe inspeksioni	9	4	51,483.45	5	57,783.21	109,266.66
Administrata-SH	6	1	14,895.63	5	49,397.85	64,293.48
Shërbimet e shëndetësisë primare	183	71	835,954.64	112	1,191,985.33	2,027,939.97
Shërbimet Sociale-Suharekë	12	7	72,246.04	5	48,743.98	120,990.02
Shërbimet kulturore	14	8	75,818.60	6	62,884.49	138,703.09
Administrata-A	8	4	56,984.84	4	54,876.81	111,861.65
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	46	1	8,216.98	45	415,512.22	423,729.20
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	761	284	2,641,250.39	477	4,531,326.01	7,172,576.40
Arsimi i mesëm i lartë	195	100	917,263.44	95	892,812.76	1,810,076.20

Burimi: Tabela BPGJ e pagave 2027–2029 për Komunën e Suharekës. Të dhënat paraqiten sipas gjinisë dhe vlerës së planifikuar të pagave.

4.2 Pagat sipas njësive organizative – 2028

Njësia organizative	Stafi	Burra	Paga burra (€)	Gra	Paga gra (€)	Total (€)
Zyra e Kryetarit	18	11	144,283.49	7	75,259.54	219,543.03
Administrata	36	24	224,088.66	12	122,772.23	346,860.89
Inspektimet	10	8	110,037.52	2	24,082.90	134,120.42
Zyra e Kuvendit Komunal	31	17	176,995.69	14	136,050.02	313,045.71
Buxhetimi	23	7	80,557.56	16	160,608.81	241,166.37
Infrastruktura Rrugore	24	23	280,091.39	1	16,044.42	296,135.81
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	1	1	9,510.90	0	0.00	9,510.90
Bujqësia	4	4	66,523.45	0	0.00	66,523.45
Shërbimet kadastrale	13	8	90,204.92	5	55,054.56	145,259.48
Planifikimi urban dhe inspeksioni	9	4	51,483.45	5	57,783.21	109,266.66
Administrata-SH	6	1	14,959.59	5	49,609.96	64,569.55
Shërbimet e shëndetësisë primare	183	71	897,217.05	112	1,279,339.22	2,176,556.27
Shërbimet Sociale-Suharekë	12	7	72,246.04	5	48,743.98	120,990.02
Shërbimet kulturore	14	8	75,818.60	6	62,884.49	138,703.09
Administrata-A	8	4	56,998.29	4	54,889.76	111,888.05
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	46	1	8,293.26	45	419,369.44	427,662.70
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	761	284	2,583,934.49	477	4,432,994.91	7,016,929.40
Arsimi i mesëm i lartë	195	100	952,736.23	95	927,339.97	1,880,076.20
TOTAL	**1394**	**583**	**5,895,980.58**	**811**	**7,922,827.42**	**13,818,808.00**

Burimi: Tabela BPGJ e pagave 2027–2029 për Komunën e Suharekës. Të dhënat paraqiten sipas gjinisë dhe vlerës së planifikuar të pagave.

4.3 Pagat sipas njësive organizative – 2029

Njësia organizative	Stafi	Burra	Paga burra (€)	Gra	Paga gra (€)	Total (€)
Zyra e Kryetarit	18	11	144,283.51	7	75,259.54	219,543.05
Administrata	36	24	224,088.66	12	122,772.23	346,860.89
Inspektimet	10	8	110,037.52	2	24,082.90	134,120.42
Zyra e Kuvendit Komunal	31	17	178,123.09	14	136,916.60	315,039.69
Buxhetimi	23	7	80,557.56	16	160,608.81	241,166.37
Infrastruktura Rrugore	24	23	280,091.39	1	16,044.42	296,135.81
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	1	1	9,510.90	0	0.00	9,510.90
Bujqësia	4	4	66,523.45	0	0.00	66,523.45
Shërbimet kadastrale	13	8	90,204.92	5	55,054.56	145,259.48
Planifikimi urban dhe inspeksioni	9	4	51,483.45	5	57,783.21	109,266.66
Administrata-SH	6	1	14,959.59	5	49,609.96	64,569.55
Shërbimet e shëndetësisë primare	183	71	897,217.05	112	1,279,339.22	2,176,556.27
Shërbimet Sociale-Suharekë	12	7	72,246.04	5	48,743.98	120,990.02
Shërbimet kulturore	14	8	75,818.60	6	62,884.49	138,703.09
Administrata-A	8	4	56,998.29	4	54,889.76	111,888.05
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	46	1	8,293.26	45	419,369.44	427,662.70
Arsimi fillor, i mesëm i ulët	761	284	2,608,643.59	477	4,475,385.81	7,084,029.40
Arsimi i mesëm i lartë	195	100	952,736.23	95	927,339.97	1,880,076.20
TOTAL	**1394**	**583**	**5,921,817.08**	**811**	**7,966,084.92**	**13,887,902.00**

Burimi: Tabela BPGJ e pagave 2027–2029 për Komunën e Suharekës. Të dhënat paraqiten sipas gjinisë dhe vlerës së planifikuar të pagave.

4.5 Rastet lehona, ndalesa dhe paga 0 € sipas kodit të programit/nënprogramit

Kjo tabelë paraqet të gjitha kodet e programit/nënprogramet të identifikuara në listën e pagave të gushtit 2026, pa përjashtuar asnjë program.

Tabela 1.11 – Rastet e lehonisë, ndalesat dhe pagat 0 € sipas kodit të programit/nënprogramit

Kodi i programit	Emërtimi	Lehoni a 70% Grua	Lehonia 30% Grua	Ndalesa 50% Grua	Ndalesa 50% Burrë	Paga 0 € Grua	Paga 0 € Burrë	Gjithsej raste*
10-624-18012-0111	Zyra e Kryetarit	0	1	0	0	1	0	2
10-624-16312-0133	Administrata	0	1	0	0	1	1	3
10-624-18623-0411	Inspekcioni	0	1	0	1	0	0	2
10-624-18012-0451	Shërbimet publike dhe emergjente	0	0	0	1	0	0	1
10-624-47012-0421	Planifikimi, Zhvillimi, Bujqësia dhe Pylltaria	0	0	0	3	0	0	3
10-624-65060-0810	Shërbimet kadastrale	0	1	0	0	0	0	1
10-624-66365-0820	Planifikimi urban dhe inspektimi	0	1	0	0	0	0	1
10-624-73750-0721	Shëndeti primar – QKMF	1	3	0	0	3	1	8
10-624-92060-0980	Administrata e Arsimit	0	0	0	2	0	0	2
10-624-92431-0911	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	0	6	0	0	1	0	7
10-624-93332-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	0	0	0	1	0	1
10-624-93333-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	1	0	0	1	0	2
10-624-93334-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	1	0	0	0	1	0	2
10-624-93335-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	1	0	0	0	1	0	2
10-624-93336-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	0	0	0	0	0	1
10-624-93337-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	1	0	0	0	0	1	1
10-624-93338-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	0	0	0	0	1	2
10-624-93339-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	0	0	0	1	0	1
10-624-93340-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	1	0	0	0	0	1
10-624-93342-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	2	0	0	1	0	3
10-624-93343-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	0	0	0	1	0	1
10-624-93346-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	1	0	0	0	0	1
10-624-93348-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	1	0	0	0	0	1
10-624-93349-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	1	0	0	0	1	2
10-624-93350-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	2	0	0	1	1	4
10-624-93351-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	0	0	0	1	0	1
10-624-93352-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	0	0	0	1	0	1
10-624-93355-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	1	0	0	0	0	1
10-624-93357-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	1	0	0	0	0	1
10-624-93359-0912	Arsimi fillor – nënprogrami	0	2	0	0	0	1	3
10-624-94531-0922	Arsimi i mesëm	0	0	0	0	1	0	1
10-624-94532-0922	Arsimi i mesëm	0	1	0	0	1	0	2
10-624-94533-0922	Arsimi i mesëm	0	1	0	0	2	0	3
GJITHSEJ KOMUNA		**5**	**29**	**0**	**7**	**20**	**7**	**68**

5. Kujdesi primar shëndetësor dhe shërbimet sociale

Ndërlidhja ligjore: në shëndetësi dhe shërbime sociale, analiza gjinore duhet të tregojë qasjen e grave, burrave, vajzave dhe djemve në shërbime. Për fëmijët, Ligji Nr. 06/L-084 kërkon mbrojtje, mirëqenie, zhvillim dhe ofrim të shërbimeve sipas nevojave të tyre; për fëmijët me aftësi të kufizuara parashihen shërbime shëndetësore, sociale dhe edukative sipas nevojave. Për këtë arsye, investimet dhe shpenzimet operative të QKMF-së dhe shërbimeve sociale duhet të monitorohen edhe sipas moshës dhe gjinisë, aty ku të dhënat administrative e mundësojnë.

Qarkorja Buxhetore 2025/01 për grantin specifik të shëndetësisë primare jep për Suharekën bazën e planifikimit me 59,722 banorë, 29,478 burra dhe 30,244 gra; 16,413 vajza të moshës 15–49 vjeç, 17,409 persona nën 14 vjeç, 4,104 mbi 65 vjeç dhe 610 persona me nevoja të veçanta. Për infrastrukturën shëndetësore parashihen 1 QKMF, 6 QMF dhe 11 AMF, me 157 staf profesional dhe 41 staf administrativ, gjithsej 198 staf. Granti bazë i shëndetësisë është 2,722,381 € për 2027. Granti i Përgjithshëm I ka ndihmuar Grantitt ë Shëndetësisë në vlerë prej 389,119.97 € për vitin 2027.

Treguesi	Suharekë – bazë e qarkores
Populisia e përdorur në formulë	59,722
Burra	29,478
Gra	30,244
Gra/vajza 15–49	16,413
Mosha <14	17,409
Mosha >65	4,104
Nevoja të veçanta	610
QKMF / QMF / AMF	1 / 6 / 11
Staf profesional / administrativ	157 / 41
Total staf	198
Granti bazë 2027	2,722,381 €

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2025/01, Tabela 6 – Granti specifik për Shëndetësi primare 2025–2027. Kjo është bazë financimi e qarkores dhe nuk duhet ngatërruar me populisinë 2024 prej 45,749 banorësh.

5.1 BPGJ në shërbimet shëndetësore

- sigurimi i qasjes së barabartë të grave, burrave, vajzave dhe djemve në QKMF, QMF dhe AMF;
- monitorimi i përdorimit të shërbimeve sipas gjinisë dhe grupmoshës;
- vëmendje e veçantë për shëndetin riprodhues të grave, fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta;
- përmirësimi i pajisjeve, autoambulancës dhe shërbimeve të dializës si pjesë e investimeve kapitale;
- ndarja e të dhënave të pacientëve/përdoruesve sipas gjinisë në raportimet vjetore, pa cenuar privatësinë.

5.2 Investimet shëndetësore 2027–2029

Projekt	2027 (€)	2028 (€)	2029 (€)	2027–2029 (€)
Pajisje për QKMF "Rexhep Kuçi"	100,000	60,000	80,000	240,000
Autoambulancë për QKMF	110,000	100,000	0	210,000
Vetura për dializë për QKMF	70,000	0	0	70,000
Ndërtim/rekonstruksion QKMF, QMF dhe AMF	40,000	70,000	80,000	190,000

5.3 Shërbimet sociale – prioritet për BPGJ-në dhe buxhetimin për fëmijë

Shërbimet sociale duhet të trajtohen veçmas në analizën e BPGJ-së, sepse përfituesit e tyre përfshijnë familje dhe persona në situata të cenueshme, fëmijë në nevojë për mbrojtje, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar dhe raste që kërkojnë ndërhyrje dhe referim institucional. Për BPGJ, rëndësi ka jo vetëm shuma e buxhetit, por edhe numri, lloji dhe gjinia e përfituesve dhe mënyra se si shërbimi arrin te grupet që kanë nevojë.

Sipas planit buxhetor 2027–2029, programi Shërbimet Sociale-Suharekë ka 12 të punësuar, prej të cilëve 7 burra dhe 5 gra. Paga e planifikuar e programit është 120,990.02 € në secilin prej viteve 2027–2029, dhe në tabelën programore të planit nuk janë paraqitur kategori të tjera shpenzimi për këtë program përveç pagave.

Viti	Stafi	Burra	Gra	Paga burra (€)	Paga gra (€)	Total programi (€)
2027	12	7	5	72,246.04	48,743.98	120,990.02
2028	12	7	5	72,246.04	48,743.98	120,990.02
2029	12	7	5	72,246.04	48,743.98	120,990.02

• Rastet sociale dhe përfituesit duhet të regjistrohen dhe raportohen sipas gjinisë dhe grupmoshës, duke respektuar privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

• Rastet e dhunës në familje duhet të përfshihen si tregues i veçantë i monitorimit të shërbimeve sociale, duke ndjekur numrin e rasteve të trajtuara, referimet, shërbimet e ofruara dhe nevojat e fëmijëve të përfshirë, pa publikuar të dhëna identifikuese.

• Për fëmijët në rrezik, fëmijët pa kujdes prindëror, familjet në vështirësi ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, planifikimi duhet të lidhë burimet me shërbimin konkret, rezultatin dhe vazhdimësinë e mbështetjes.

• Raportimi vjetor duhet të mundësojë dallimin ndërmjet numrit të rasteve, numrit të përfituesve dhe numrit të shërbimeve të ofruara, sepse këta tregues nuk janë të njëjtë.

Burimi: Plani i Buxhetit 2027–2029 dhe Tabela BPGJ e pagave 2027–2029. Për rastet e dhunës në familje dhe rastet sociale nuk janë shtuar shifra të reja pa një tabelë administrative të burimit në materialet e shqyrtuara, ato janë përfshirë si tregues të domosdoshëm të monitorimit.

6. Subvencionet dhe përfituesit sipas gjinisë

Ndërlidhja ligjore: subvencionet duhet të analizohen sipas gjinisë së përfituesve dhe, kur masa synon familjet ose fëmijët, sipas grupmoshës dhe nevojës së mbështetjes. BPGJ kërkon që efekti i shpërndarjes së burimeve të jetë i dukshëm, ndërsa Ligji Nr. 06/L-084 kërkon mbështetje institucionale për familjet dhe shërbime për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës. Për këtë arsye, listat e përfituesve duhet të mundësojnë raportim të ndarë sipas gjinisë, pa nxjerrë të dhëna personale të panevojshme për fëmijët.

Komuna e Suharekës ka një praktikë të gjerë të publikimit të thirrjeve, vendimeve preliminare dhe përfundimtare për subvencionimin e OJQ-ve dhe për mbështetje në sektorë të ndryshëm. Faqja zyrtare e komunës tregon publikime për vitin 2026 dhe arkivën e viteve 2025 dhe 2024, ndërsa raporti vjetor 2025 dokumenton aktivitete të kulturës, rinisë dhe sportit dhe përmend mbështetjen e OJQ-ve dhe klubeve sportive.

Fusha	Evidencë nga publikimet	Përdorimi në BPGJ
Bujqësi	Pagesa direkte 2026 për qumësht, viça, zogj dhe grurë	Raportim sipas gjinisë së fermerëve
Kulturë/Rini/Sport/ Mërgatë	Thirrje dhe vendime për subvencionimin e OJQ-ve 2024–2026	Përfitues gra/vajza dhe burra/djem
Sport	Thirrje publike për mbështetje të OJQ-ve sportive 2026	Pjesëmarrja gjinore në klube dhe aktivitete
Arsim	Lista e përfituesve të bursave për nxënës 2025	Ndarja sipas gjinisë dhe nivelit
Shërbime sociale	Mbështetje e personave/familjeve sipas nevojës	Përfitues sipas gjinisë/moshës

Burimi: faqja zyrtare e Komunës së Suharekës, publikimet e Drejtorive dhe raporti vjetor 2025. Në dokumentet publike të shqyrtuara, ndarja gjinore nuk është e njëtrajtshme për çdo skemë; për këtë arsye BPGJ propozon që thirrjet dhe raportet e realizimit të kërkojnë sistematikisht të dhëna Gra/Burra.

6.1 Buxheti i subvencioneve në planin 2027–2029

Viti	Subvencione & transfere (€)	Subvencione/THV (€)	Gjithsej për komponentët e subvencioneve (€)
2027	680,000	680,000	1,360,000
2028	717,000	805,000	1,522,000
2029	735,000	845,000	1,580,000

Analiza gjinore e subvencioneve duhet të bëhet në dy nivele: (1) gjatë planifikimit, duke përcaktuar objektiva të matshme për pjesëmarrjen e grave dhe burrave; dhe (2) pas realizimit, duke përdorur listat faktike të përfituesve. Ky mekanizëm e bën BPGJ-në të verifikueshme dhe jo vetëm përshkruese.

7. Ndërlidhja e BPGJ-së me investimet kapitale – Tabela 4.2

Ndërlidhja ligjore: investimet kapitale klasifikohen sipas ndikimit të tyre te gratë, burrat, vajzat dhe djemtë dhe, për projektet që prekin fëmijët, sipas ndikimit në qasje, siguri, arsim, shëndetësi, sport, mobilitet dhe hapësira publike. Ligji Nr. 06/L-084 kërkon që interesi më i mirë i fëmijës të jetë konsideratë mbizotëruese në vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët; prandaj projektet e shkollave, çerdheve, parqeve, sportit dhe shërbimeve shëndetësore duhet të analizohen edhe nga kjo perspektivë.

Tabela 4.2 e PIP/KAB të Komunës së Suharekës paraqet investime kapitale prej 5,307,249 € në vitin 2027, 5,689,321 € në vitin 2028 dhe 6,735,414 € në vitin 2029, ose 17,731,984 € për periudhën 2027–2029. Analiza gjinore e investimeve duhet të fokusohet te përfituesit dhe ndikimi i projektit në qasje, siguri, mobilitet, arsim, shëndetësi, sport dhe kushte jetese.

Viti	BKK (€)	THV (€)	Gjithsej (€)
2027	3,920,452	1,386,797	5,307,249
2028	4,371,785	1,317,536	5,689,321
2029	5,327,258	1,408,156	6,735,414
2027–2029	13,619,495	4,112,489	17,731,984

7.1 Projekte me ndikim të drejtpërdrejtë në BPGJ

Projekti	2027 (€)	2028 (€)	2029 (€)	Ndikimi BPGJ
QKMF – pajisje mjekësore	100,000	60,000	60,000	Gra/burra, vajza/djem
Autoambulancë QKMF	110,000	100,000	0	Qasje shëndetësore
Vetura për dializë	70,000	0	0	Qasje në trajtim
QKMF/QMF/AMF – ndërtim/rekonstruksion	40,000	70,000	80,000	Popullsia sipas gjinisë/moshës
Salla sportive në Peqan	200,000	100,000	100,000	Vajza/djem dhe të rinj
Rikonstruimi i SHFMU Sllapuzhan/etj.	150,000	140,000	50,000	Nxënës dhe staf
Rikonstruimi i SHP "Avdyl Rama"	50,000	0	40,000	Nxënës dhe staf
Rikonstruimi i shkollave në disa vendbanime	57,631	60,000	65,000	Nxënës/vajza/djem

Burimi: Tabela 4.2 – Investimet Kapitale 2027–2029, Komuna e Suharekës. Vlerat paraqiten sipas planit të projektit; ndikimi gjinor është klasifikim analitik i BPGJ-së, jo ndarje faktike e përfituesve.

7.2 Infrastruktura, siguria dhe qasshmëria

Për BPGJ dhe buxhetimin për fëmijë, infrastruktura nuk vlerësohet vetëm sipas shumës së investimit. Vlerësimi duhet të marrë parasysh sigurinë e fëmijëve, qasjen në shkolla dhe shërbime, ndriçimin, mobilitetin dhe përdorimin e hapësirave publike. Kur një projekt nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me fëmijët, kjo duhet të pasqyrohet si ndikim i tërthortë dhe jo të paraqitet si përfitim i drejtpërdrejtë.

Investimet në rrugë, kanalizime, ujësjellës dhe ndriçim publik kanë ndikim të tërthortë gjinor. Për BPGJ, vlerësimi duhet të marrë parasysh përdorimin e hapësirave nga gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, lëvizjen e nxënësve, sigurinë gjatë orëve të mbrëmjes dhe qasjen e personave me aftësi të kufizuara.

8. Analiza e ndikimit gjinor dhe korniza e monitorimit

Korniza e monitorimit zbatohet në dy drejtime të integruara: (1) tregues të ndarë sipas gjinisë për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë; dhe (2) tregues të buxhetimit për fëmijë që matin qasjen, përfitimin dhe rezultatet për fëmijët. Kjo përputhet me kërkesën që perspektiva gjinore të integrohet në politikat dhe burimet publike dhe me detyrimin institucional për monitorimin e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës në nivel lokal.

Që BPGJ-ja të shërbejë si instrument menaxherial, çdo program duhet të ketë tregues të matshëm. Për Suharekën, monitorimi duhet të fokusohet në pesë fusha: burimet, përfituesit, rezultatet, qasja dhe ndikimi.

Fusha	Treguesi	Ndarja
Pagat	Numri i stafit dhe vlera e pagave	Gra/Burra
Arsimi	Nxënësit që vijojnë shkollimin	Vajza/Djem + nivel
Subvencionet	Numri dhe vlera e përfitimeve	Gra/Burra
Shëndetësia	Përdoruesit e shërbimeve	Gra/Burra + moshë
Investimet	Përfituesit e projekteve	Gra/Burra/Vajza/Djem
Sporti	Pjesëmarrësit/klubet e mbështetura	Vajza/Djem, Gra/Burra
Shërbimet sociale	Rastet dhe përfituesit	Gra/Burra + moshë
Buxhetimi	Mjetet e planifikuara dhe realizuara	Program/kategori/gjini

8.1 Parimi i të dhënave faktike dhe përllogaritjeve

Në këtë dokument dallohen të dhënat faktike nga të dhënat planifikuese. Të dhënat e popullsisë dhe arsimit janë marrë nga ASK/MASHT, ndërsa pagat, buxheti dhe investimet nga dokumentet e Komunës së Suharekës. Aty ku publikimet nuk ofrojnë ndarje gjinore, dokumenti nuk e paraqet atë si fakt; në vend të kësaj propozon mbledhjen e saj për raportimin e realizimit.

8.3 Burimet e financimit dhe limitet e shpenzimeve 2027–2029

Për të siguruar një pasqyrim të plotë dhe transparent të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor, analiza lidhet drejtpërdrejt me Tabelën 4.1 të Buxhetit Komunal 2027–2029. Të dhënat më poshtë paraqesin burimet e financimit dhe nënzërat e shpenzimeve brenda limiteve të planifikuara, duke dalluar financimin nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe të Hyrat Vetanake.

Burimi i financimit	2027 (€)	2028 (€)	2029 (€)
Granti i Përgjithshëm	10,680,306	10,957,718	11,818,188
Granti Specifik për Arsim	8,145,221	8,389,578	8,641,265
Granti Specifik për Shëndetësi	2,505,143	2,580,297	2,657,706
Gjithsej Buxheti i Kosovës (BKK)	**21,330,670**	**21,927,593**	**23,117,159**
Të Hyrat Vetanake (THV)	3,046,297	3,137,536	3,282,156
Gjithsej Buxheti Komunal	**24,376,967**	**25,065,129**	**26,399,316**

Nga këndvështrimi i BPGJ-së, kjo ndarje është e rëndësishme sepse çdo burim financimi mbështet shërbime dhe masa publike që duhet të analizohen sipas përfitimit të grave, burrave, vajzave dhe djemve. Të Hyrat Vetanake nuk duhet të trajtohen si burim neutral ndaj gjinisë, por të ndiqen në të njëjtën mënyrë si grantet.

8.3.1 Nënzërat e shpenzimeve brenda limiteve buxhetore

Tabela në vijim paraqet limitet e shpenzimeve sipas nënzërave ekonomikë dhe i ndan ato ndërmjet financimit nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe Të Hyrave Vetanake. Kjo strukturë e bën të mundur lidhjen e analizës gjinore me të gjithë buxhetin dhe jo vetëm me një kategori të vetme.

Nënzëri i shpenzimeve	BKK 2027 (€)	THV 2027 (€)	Gjithsej 2027 (€)	BKK 2028 (€)	THV 2028 (€)	Gjithsej 2028 (€)	BKK 2029 (€)	THV 2029 (€)	Gjithsej 2029 (€)
Paga dhe shtesa	13,750,057	0	13,750,057	13,818,808	0	13,818,808	13,887,902	0	13,887,902
Mallra dhe shërbime	2,594,361	843,500	3,437,861	2,625,000	872,000	3,497,000	2,767,000	885,000	3,652,000
Shpenzime komunale	385,800	136,000	521,800	395,000	143,000	538,000	400,000	144,000	544,000
Subvencione dhe transfere	680,000	680,000	1,360,000	717,000	805,000	1,522,000	735,000	845,000	1,580,000
Shpenzime kapitale	3,920,452	1,386,797	5,307,249	4,371,785	1,317,536	5,689,321	5,327,258	1,408,156	6,735,414
GJITHSEJ	**21,330,670**	**3,046,297**	**24,376,967**	**21,927,593**	**3,137,536**	**25,065,129**	**23,117,159**	**3,282,156**	**26,399,316**

Kjo tabelë përbën bazën financiare të analizës së BPGJ-së: pagat dhe shtesat lidhen me strukturën e stafit; mallrat dhe shërbimet me ofrimin e shërbimeve publike; shpenzimet komunale me funksionalitetin e objekteve; subvencionet dhe transferet me përfituesit; ndërsa investimet kapitale me qasjen dhe përdorimin e infrastrukturës publike. Për secilin nënzë duhet të ndiqen, sipas mundësisë së të dhënave, përfituesit sipas gjinisë dhe ndikimi te vajzat, djemtë, gratë dhe burrat.

8.3.2 Përmbledhja sipas grupeve kryesore të programeve

Grupi i programeve	2027 (€)	2028 (€)	2029 (€)	Roli në BPGJ
Administrata komunale	10,892,980.23	11,586,904.43	12,788,991.43	Staf, paga, shërbime, subvencione dhe investime
Shëndetësia	3,084,262.97	3,132,556.27	3,159,556.27	Qasje në kujdesin primar dhe vazhdimësi e shërbimeve
Arsimi dhe shkenca	10,399,723.80	10,345,668.30	10,450,768.30	Arsim, fëmijë, staf arsimor dhe infrastrukturë
GJITHSEJ KOMUNA	**24,376,967.00**	**25,065,129.00**	**26,399,316.00**	**Baza e përgjithshme e analizës BPGJ**

8.3.3 Financimi i investimeve kapitale sipas burimit

Tabela 4.2 e Financimit të Investimeve Kapitale Komunale paraqet investimet sipas burimit të financimit dhe sipas vitit të realizimit. Për Suharekën, investimet kapitale të planifikuara për periudhën 2027–2029 arrijnë gjithsej 17,731,984 €, prej të cilave 13,619,495 € nga Granti Qeveritar dhe 4,112,489 € nga Të Hyrat Vetanake.

Burimi i financimit	2027 (€)	2028 (€)	2029 (€)	Gjithsej 2027–2029 (€)
Grant Qeveritar (GQ)	3,920,452	4,371,785	5,327,258	13,619,495
Të Hyrat Vetanake (THV)	1,386,797	1,317,536	1,408,156	4,112,489
GJITHSEJ INVESTIME KAPITALE	**5,307,249**	**5,689,321**	**6,735,414**	**17,731,984**

Në analizën e BPGJ-së, investimet kapitale duhet të vlerësohen jo vetëm sipas shumës së investimit, por edhe sipas funksionit të projektit, qasshmërisë, sigurisë, përdorimit nga gra dhe burra dhe ndikimit te vajzat dhe djemtë. Tabela 4.2 përmban projektet dhe burimet konkrete të financimit; ajo është përdorur si burim zyrtar për pasqyrimin e investimeve kapitale në këtë dokument.

8.3.4 Lidhja me detajet e planifikimit të stafit dhe pagave

Formulari PCF4 për Komunën e Suharekës përmban detajet e pozicioneve, koeficientëve, numrit të stafit dhe kërkesave buxhetore për periudhën 2027–2029. Në të njëjtën kohë, Tabela 4.1 paraqet limitin përfundimtar të pagave dhe shtesave në nivel komunal. Për këtë arsye, në BPGJ përdoren Tabela 4.1 dhe tabelat e verifikuara të pagave sipas gjinisë si bazë kryesore për pasqyrimin financiar, ndërsa PCF4 shërben si dokument mbështetës për detajet e strukturës së stafit dhe pozicioneve.

Shënim teknik: në Tabelën 4.1 për vitin 2029, shuma e tre granteve kryesore të BKK-së (11,818,188 € + 8,641,265 € + 2,657,706 €) është 23,117,159 €, ndërsa rreshti i totalit të BKK-së në burimin e financimit paraqet 23,117,160 €. Dokumenti nuk e korrigjon në mënyrë të njëanshme këtë diferencë prej 1 €, por e evidenton për transparencë dhe harmonizim teknik me burimin zyrtar.

8.4 Integrimi i plotë i BPGJ-së, barazisë gjinore dhe buxhetimit për fëmijë

Tabela më poshtë përmbledh mënyrën se si secila kategori kryesore e buxhetit trajtohet në këtë dokument në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe me parimet e Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës. Kjo nuk nënkupton se çdo shpenzim ka ndikim të drejtpërdrejtë te fëmijët; ndikimi shënohet vetëm aty ku mbështetet nga funksioni i programit ose nga përfituesit e identifikueshëm.

Kategoria	Zbatimi i BPGJ / Ligji 05/L-020	Buxhetimi për fëmijë / Ligji 06/L-084	Treguesi i monitorimit
Paga dhe shtesa	Gra/burra në staf; paga dhe shtesa sipas gjinisë; lehonia dhe zëvendësimet	Vazhdimësia e shërbimeve për fëmijë dhe mbështetja e kujdesit familjar	Staf/paga sipas gjinisë; raste lehonie/zëvendësimi
Arsimi	Qasje dhe përfitim sipas vajzave/djemve; staf sipas gjinisë	Qasje gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe cilësi e arsimit	Nxënës vajza/djem; staf; investime në shkolla/çerdhe
Shëndetësia	Përdorues gra/burra/vajza/djem sipas të dhënave	Qasje e fëmijëve në shërbime shëndetësore sipas nevojës	Përdorues sipas gjinisë/moshës; pajisje/shërbime
Shërbimet sociale	Përfituesit sipas gjinisë dhe grupeve të cenueshme	Mbrojtja, mirëqenia dhe shërbimet për fëmijët dhe familjet në nevojë	Raste/përfitues sipas gjinisë dhe moshës
Subvencione dhe transfere	Përfitues gra/burra; objektiva të matshme	Përfitimet për familje/fëmijë kur programi i synon	Nr. dhe vlera e përfituesve sipas gjinisë
Mallra dhe shërbime	Ndikimi i shërbimeve publike te përdoruesit sipas gjinisë	Vetëm kur shërbimi lidhet me fëmijët ose institucionet e tyre	Përdorues dhe shërbime sipas gjinisë/moshës
Shpenzime komunale	Qasje dhe përdorim i objekteve publike nga gra/burra	Siguri dhe funksionalitet i objekteve të përdorura nga fëmijët	Objekte/shërbime dhe grupet e përdoruesve
Investime kapitale	Analizë e ndikimit te gratë/burrat dhe vajzat/djemtë	Qasje, siguri, arsim, shëndetësi, sport dhe hapësira për fëmijë	Përfitues/projekt; ndikimi sipas gjinisë dhe moshës
Bujqësi/zhvillim ekonomik	Pjesëmarrja e grave dhe burrave në përfitime ekonomike	Ndikimi te familjet/fëmijët vetëm kur programi e mbështet këtë	Përfitues sipas gjinisë; programi dhe vlera
Kulturë, rini dhe sport	Pjesëmarrja e vajzave/djemve dhe grave/burrave	Pjesëmarrja dhe qasja e fëmijëve dhe të rinjve	Pjesëmarrës sipas gjinisë dhe moshës
Administratë	Integrimi i barazisë gjinore në planifikim dhe raportim	Mbështet kapacitetin institucional për shërbimet ndaj fëmijëve	Raportim gjinor dhe tregues të shërbimeve

9. Përfundimi

Plani Buxhetor 2027–2029 i Komunës së Suharekës ofron bazë të gjerë për integrimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor. Struktura e pagave tregon 1,394 të punësuar në planifikimin gjinor, me 811 gra dhe 583 burra. Populisia 2024 tregon 23,033 gra dhe 22,716 burra. Të dhënat e ASK-së për personat 5–29 vjeç që vijojnë shkollimin evidentojnë 10,231 persona, 5,005 gra dhe 5,226 burra. Në shëndetësi, baza e grantit specifik parashikon një rrjet prej 1 QKMF, 6 QMF dhe 11 AMF dhe 198 staf në total, ndërsa investimet e Tabelës 4.2 përfshijnë pajisje, autoambulancë, shërbime të dializës, objekte shëndetësore, shkolla dhe infrastrukturë publike. Në kuadër të buxhetimit për fëmijë, analiza e rasteve të lehonisë dhe planifikimi i zëvendësimeve të përkohshme përbëjnë pjesë të rëndësishme të vazhdimësisë së shërbimeve arsimore dhe të respektimit të interesit më të mirë të fëmijës.

Prioriteti për periudhën 2027–2029 duhet të jetë kalimi nga përshkrimi i buxhetit në matjen e rezultateve: kush përfiton, sa përfiton dhe a po përmirësohet qasja e grave, burrave, vajzave dhe djemve në shërbimet publike. Për këtë arsye, ndarja e të dhënave sipas gjinisë në subvencione, arsim, shëndetësi dhe raportimin e projekteve kapitale duhet të bëhet pjesë e rregullt e ciklit buxhetor.

Agim Bylykbashi

Zyrtar Kryesor Financiar **Datë: 29.09.2026** **Nënshkrimi:**

Bali Muharremaj

Kryetar i Komunës së Suharekës (ZKA) **Datë: 29.09.2026** **Nënshkrimi:**